

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE METODOLOGJIA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT URBAN BASHKIA SHKODER ZONA PERENDIMORE**

### **1. Rregulla të përgjithshme për realizimin e shërbimit**

Shërbimi i pastrimit realizohet në mënyrë të organizuar dhe të vazhdueshme në të gjithë territorin e zonës së shërbimit, në përputhje me kërkesat teknike të këtij dokumenti dhe me organizimin operativ të përcaktuar për realizimin e operacioneve të pastrimit. Operatori i shërbimit organizon aktivitetin e ekipeve të punës dhe të mjeteve të specializuara në bazë të itinerareve dhe grafikëve të punimeve, të cilët përcaktojnë mënyrën e operimit në terren dhe frekuencën e realizimit të çdo shërbimi.

Grafikët e punimeve përfshijnë në mënyrë të detajuar:

Itineraret e mjeteve dhe të ekipeve të pastrimit;

Oraret e operimit të shërbimit;

Frekuencën e realizimit të operacioneve të pastrimit;

Mjetet dhe personelin e angazhuar për çdo operacion.

Grafikët e punimeve hartohen nga operatori i shërbimit dhe miratohen nga Autoriteti Kontraktor. Në funksion të nevojave operacionale, organizimit të trafikut apo faktorëve të tjerë që ndikojnë në realizimin e operacioneve të pastrimit, këta grafikë mund të përditësohen gjatë periudhës së realizimit të kontratës me miratimin e Autoritetit Kontraktor.

Realizimi i shërbimit monitorohet nga Autoriteti Kontraktor, i cili verifikon respektimin e kërkesave teknike të përcaktuara në këtë dokument, realizimin e itinerareve të punës dhe nivelin e pastërtisë së zonës së shërbimit.

Operacionet e pastrimit duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të mos pengohet qarkullimi rrugor dhe të garantohet siguria e qytetarëve gjatë kryerjes së punimeve.

Punonjësit e angazhuar në realizimin e shërbimit duhet të jenë të pajisur me uniformë pune dhe pajisje mbrojtëse personale në përputhje me rregullat e sigurisë dhe higjienës në punë.

Gjatë realizimit të operacioneve të pastrimit ndalohet hedhja e mbetjeve në puseta, në rrjetin e kanalizimeve, në hapësira të gjelbra apo në çdo zonë tjetër që mund të shkaktojë ndotje mjedisore.

Të gjitha mjetet dhe pajisjet e përdorura për realizimin e shërbimit duhet të mbahen në gjendje të mirë teknike dhe të jenë në përputhje me standardet mjedisore të Bashkimit European, minimalisht \*\*Euro 5 ose standarde më të larta\*\*.

Operatori i shërbimit siguron mirëmbajtjen e rregullt të mjeteve dhe pajisjeve të përdorura në realizimin e operacioneve të pastrimit, me qëllim garantimin e funksionimit të tyre të sigurt dhe efikas gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit.

### **2. Organizimi operativ i shërbimit**

Organizimi operativ i shërbimit të pastrimit urban realizohet në bazë të strukturës së përcaktuar për realizimin e operacioneve të pastrimit në territorin e zonës së shërbimit.

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë një organizim të tillë të punës që garanton realizimin e vazhdueshëm dhe efikas të të gjitha operacioneve të pastrimit, në përputhje me itineraret dhe grafikët e punimeve të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

Struktura operacionale e shërbimit përfshin:

- personelin drejtues dhe teknik të shërbimit;
- ekipet operacionale të pastrimit;
- mjetet dhe pajisjet e përdorura për realizimin e shërbimit.

### **Struktura e organizimit të shërbimit**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë strukturën e nevojshme për drejtimin dhe koordinimin e shërbimit, e cila përfshin:

- drejtuesin teknik të shërbimit;
- përgjegjësit e sektorëve të shërbimit;
- personelin operativ të angazhuar në realizimin e operacioneve të pastrimit;
- shoferët e mjeteve të shërbimit.

Drejtuksi teknik i shërbimit është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e përgjithshëm të operacioneve të pastrimit dhe për bashkëpunimin me Autoritetin Kontraktor për realizimin e shërbimit.

### **Organizimi i ekipeve të punës**

Realizimi i operacioneve të pastrimit kryhet nga ekipet operacionale të organizuara në bazë të llojit të shërbimit dhe itinerareve të punës.

Në varësi të natyrës së operacioneve të pastrimit, ekipet e punës mund të përfshijnë:

- punonjës për fshirjen manuale të rrugëve dhe trotuareve;
- ekipe për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kontejnerëve.

Numri i punonjësve të angazhuar në realizimin e shërbimit përcaktohet në bazë të modelit të dimensionimit të shërbimit dhe të volumit të punimeve.

### **Organizimi i mjeteve të shërbimit**

Mjetet e përdorura për realizimin e operacioneve të pastrimit organizohen në bazë të itinerareve të punës dhe grafikëve të operimit.

Në realizimin e shërbimit përdoren mjete të specializuara për:

- larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve;
- transportin dhe mirëmbajtjen e kontejnerëve.

Numri i mjeteve dhe kapaciteti i tyre përcaktohen në bazë të volumit të punimeve dhe të modelit të dimensionimit të shërbimit.

### **Koordinimi i operacioneve të pastrimit**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë koordinimin e vazhdueshëm të ekipeve të punës dhe të mjeteve të shërbimit për realizimin efikas të operacioneve të pastrimit.

Koordinimi i operacioneve realizohet nëpërmjet:

- planifikimit të itinerareve të punës;
- organizimit të turneve të punës;
- monitorimit të realizimit të operacioneve në terren.

## **3. Itineraret dhe grafiku i punimeve**

Realizimi i operacioneve të pastrimit urban organizohet në bazë të itinerareve të punës dhe grafikëve të punimeve, të cilët përcaktojnë mënyrën e realizimit të shërbimit në territorin e zonës së shërbimit.

Itineraret e punës përfshijnë segmentet rrugore dhe hapësirat publike ku realizohen operacionet e pastrimit, si dhe renditjen e tyre sipas planit të operimit të ekipeve dhe mjeteve të shërbimit.

Grafikët e punimeve përcaktojnë:

- itineraret e mjeteve dhe të ekipeve të pastrimit;
- frekuencën e realizimit të operacioneve të pastrimit;

- oraret e operimit të shërbimit;
- mjetet dhe personelin e angazhuar për realizimin e çdo operacioni.

Itineraret dhe grafikët e punimeve hartohen nga operatori i shërbimit në bazë të organizimit operativ të shërbimit dhe të volumit të punimeve të përcaktuara në këtë dokument.

Këto itinerare dhe grafikë miratohen nga Autoriteti Kontraktor dhe përbëjnë bazën për organizimin dhe realizimin e operacioneve të pastrimit në territorin e zonës së shërbimit. Në funksion të nevojave operacionale, organizimit të trafikut apo faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë në realizimin e shërbimit, itineraret dhe grafikët e punimeve mund të përditësohen gjatë periudhës së realizimit të kontratës me miratimin e Autoritetit Kontraktor.

Operatori i shërbimit është përgjegjës për respektimin e itinerareve të miratuara dhe për realizimin e operacioneve të pastrimit sipas frekuencave të përcaktuara në këtë dokument. Teksti për këtë seksion plotësohet sipas kërkesave të kontratës dhe organizimit të shërbimit.

#### **4. Siguria dhe mbrojtja në punë**

Operatori i shërbimit është përgjegjës për respektimin e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë realizimit të operacioneve të pastrimit urban.

Realizimi i shërbimit duhet të kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet e sigurisë në punë, me qëllim garantimin e mbrojtjes së punonjësve të angazhuar në shërbim, si dhe të qytetarëve dhe përdoruesve të rrugës.

Operatori i shërbimit është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e rreziqeve gjatë realizimit të operacioneve të pastrimit dhe për garantimin e kushteve të sigurta të punës për personelin e angazhuar në shërbim.

Punonjësit e angazhuar në realizimin e shërbimit duhet të jenë të pajisur me uniformë pune dhe me pajisje mbrojtëse personale, në përputhje me natyrën e punës që kryejnë.

Pajisjet mbrojtëse personale duhet të përfshijnë, ndër të tjera:

- jelek reflektues për rritjen e dukshmërisë në rrugë;
- doreza mbrojtëse;
- këpucë sigurie;
- pajisje të tjera mbrojtëse sipas natyrës së operacioneve të pastrimit.

Gjatë realizimit të operacioneve të pastrimit në rrugë dhe hapësira publike, operatori i shërbimit duhet të marrë masa për garantimin e sigurisë së qarkullimit rrugor dhe të përdoruesve të rrugës.

Në rastet kur realizimi i shërbimit kërkon ndërhyrje në segmente rrugore me qarkullim të automjeteve, operatori duhet të vendosë sinjalistikën përkatëse të përkohshme dhe të marrë masat e nevojshme për shmangien e rreziqeve gjatë kryerjes së punimeve.

Operatori i shërbimit mban përgjegjësi për çdo dëmtim që mund të shkaktohet gjatë realizimit të operacioneve të pastrimit si pasojë e mosrespektimit të rregullave të sigurisë në punë.

### **ZËRAT E SHËRBIMIT**

#### **Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve:**

Pershkrimi I shërbimit: Ky shërbim konsiston në grumbullimin dhe transportin e mbetjeve deri në pikën fundore të depozitimit të tyre konkretisht Landfill i Bushatit. Zona perendimore, e përbërë nga njësitë administrative Velipoje, Dajç, Ana e Malit dhe Berdicë është një zonë me tipologji komplekse ku ndërthuret zona rurale, zona turistike dhe zona

ne zhvillim me infrastrukturë rrugore mjaft të mire. Ne përputhje me këtë tipologji si edhe për të siguruar një shërbim eficient dhe me kosto jo të lartë, ndarja e shërbimit për këtë zonë është konceptuar si më poshtë:

- Zona rurale e ndare në dy nënzona ku shërbimi do të kryhet 3 herë në javë për secilën nënzonë (Velipoje pjesa rurale-Ana e Malit-Dajç-Berdicë-1 dhe Velipoje pjesa rurale-Ana e Malit-Dajç-Berdicë-2) nga 156 dite secila.
- Zona Velipoje pranë plazhit ku shërbimi do të kryhet 7 herë në javë për 365 ditë (natën)
- Zona turistike ku shërbimi do të kryhet 7 herë në javë përgjatë periudhës turistike 15 Qershor-15 Shtator
- Shërbimi i dytë i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për zonën Velipoje (ditën) për 93 ditë gjatë periudhës turistike)

Ky shërbim përfshin dhe pastrimin e pikës së grumbullimit të mbetjeve në një sipërfaqe 10 m<sup>2</sup> pranë konteinerëve. Në mbarimin e ngarkimit të mbetjeve, konteineret vendosen me rregullsi në vendin e përcaktuar. Operatori i shërbimit duhet të mirëmbajë konteineret dhe të raportojë apo të marrë masa të menjëhershme për riparimin apo zëvendësimin e tyre në rast se konstaton demtime. Levizshmëria e makinave duhet të bëhet në përputhje me rrugetimin e parashikuar të tyre në mënyrë që ky shërbim të jetë eficient. Grafiku I punimeve duhet të zbatohet në mënyrë rigorozë dhe të nxitet komunitetit për të depozituar mbetjet në oraret përpara së makinat të vijnë në pikat e grumbullimit të mbetjeve për të tërhequr ato.

## **5. Fshirja manuale e rrugëve dhe trotuareve**

### **5.1 Përshkrimi i shërbimit**

Shërbimi i fshirjes manuale konsiston në realizimin e operacioneve të pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike në territorin e zonës së shërbimit, me qëllim largimin e mbetjeve të vogla, pluhurit dhe papastërtive nga sipërfaqet urbane.

Ky shërbim realizohet në segmentet rrugore dhe hapësirat ku përdorimi i mjeteve mekanike nuk është i mundur ose nuk është i përshtatshëm për shkak të karakteristikave të territorit.

### **5.2 Volumi i shërbimit**

Volumi i shërbimit të fshirjes manuale përcaktohet në bazë të analizës së territorit dhe të modelit të dimensionimit të shërbimit të paraqitur në tabelat analitike të përgatitura në modelin e llogaritjes.

Ky volum përfshin:

- sipërfaqen totale të rrugëve dhe trotuareve që përfshihen në shërbim: 5200 m<sup>2</sup>;
- frekuencën e realizimit të operacionit të pastrimit: 7 herë në javë për 93 ditë;
- segmentet rrugore të përfshira në itinerarin e pastrimit, në përputhje me volumin e punimeve të përcaktuar në modelin e dimensionimit të shërbimit.

### **5.3 Organizimi i shërbimit**

Shërbimi i fshirjes manuale realizohet nga punonjësit e pastrimit të organizuar në ekipe pune, të cilët operojnë në bazë të itinerareve të përcaktuara për realizimin e operacioneve të pastrimit.

Organizimi i punës bazohet në ndarjen e territorit në segmente pune, ku çdo punonjës është përgjegjës për realizimin e operacioneve të pastrimit në segmentin e caktuar të itinerarit të punës.

Numri i punonjësve të angazhuar në realizimin e këtij shërbimi 1 punonjes efektiv . Ky numer përcaktohet në bazë të volumit të punimeve dhe të normave teknike të produktivitetit të përdorura për dimensionimin e shërbimit.

#### **5.4 Metodologjia e realizimit të shërbimit**

Realizimi i shërbimit të fshirjes manuale kryhet nga ekipet operacionale të operatorit të shërbimit në përputhje me itineraret e përcaktuara për realizimin e operacioneve të pastrimit.

Procesi operacional përfshin fazat e mëposhtme.

##### **Vendosja e ekipit të punës**

Në fillim të çdo turni pune, punonjësit vendosen në segmentet rrugore të përcaktuara në itinerarin e punës dhe pajisen me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e operacioneve të pastrimit.

##### **Mbledhja e mbetjeve të mëdha**

Në fazën fillestare të operacionit realizohet mbledhja e mbetjeve më të mëdha që mund të jenë të pranishme në sipërfaqen e rrugës ose të trotuarit.

##### **Fshirja e sipërfaqes**

Pas largimit të mbetjeve më të mëdha realizohet fshirja e sipërfaqes së rrugës dhe trotuareve me mjete manuale për largimin e pluhurit dhe papastërtive.

##### **Grumbullimi i mbetjeve**

Mbetjet e grumbulluara gjatë procesit të fshirjes vendosen në pika të përkohshme përgjatë itinerarit të punës.

##### **Transportimi i mbetjeve**

Mbetjet e grumbulluara transportohen drejt pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane ose depozitohen në kontejnerët përkatës të mbetjeve.

#### **5.5 Parametrat teknikë**

Parametrat teknikë për realizimin e këtij shërbimi përcaktohen në bazë të normave të produktivitetit të përdorura për dimensionimin e shërbimit.

Norma e produktivitetit për këtë shërbim përcakton sipërfaqen mesatare që mund të pastrohet nga një punonjës gjatë një dite pune dhe përdoret si bazë për llogaritjen e numrit të punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimit.

#### **5.6 Mjetet dhe pajisjet**

Për realizimin e shërbimit të fshirjes manuale përdoren pajisje dhe mjete të përshtatshme për realizimin e operacioneve të pastrimit, të cilat përfshijnë:

- fshesa për pastrimin e sipërfaqeve;
- lopata dhe mjete të tjera për grumbullimin e mbetjeve;
- karroca ose mjete të vogla transporti për mbledhjen e mbetjeve;
- qese ose kontejnerë për depozitimin e mbetjeve.

#### **5.7 Grafiku i punimeve**

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të fshirjes manuale përgatiten nga operatori i shërbimit në bazë të itinerareve të punës dhe të frekuencave të realizimit të operacioneve të pastrimit.

Grafikët e punimeve miratohen nga Autoriteti Kontraktor dhe përbëjnë bazën për organizimin dhe realizimin e operacioneve të fshirjes manuale në territorin e zonës së shërbimit.

## 6. Pastrimi i sipërfaqeve të plazhit

### 6.1 Përshkrimi i shërbimit

Shërbimi i pastrimit të sipërfaqeve të plazhit përfshin realizimin e operacioneve të pastrimit dhe mirëmbajtjes së zonave të plazhit që përfshihen në territorin e zonës së shërbimit.

Ky shërbim synon ruajtjen e kushteve të përshtatshme të pastërtisë dhe higjienës në zonat e plazhit, duke përfshirë mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të depozituara në sipërfaqen e rërës, mbetjeve të shpërndara nga aktivitetet rekreative dhe çdo lloj mbetjeje tjetër që mund të ndikojë në cilësinë e mjedisit bregdetar.

Operacionet e pastrimit realizohen kryesisht me mjete manuale për të garantuar mbrojtjen e sipërfaqes së rërës dhe të mjedisit natyror të zonës së plazhit.

### 6.2 Volumi i shërbimit

Volumi i shërbimit të pastrimit të sipërfaqeve të plazhit përcaktohet në bazë të analizës së territorit dhe të modelit të dimensionimit të shërbimit të paraqitur në tabelat analitike të përgatitura në modelin e llogaritjes.

Ky volum përfshin:

- sipërfaqen e zonës së plazhit që përfshihet në operacionin e pastrimit: **1000 m<sup>2</sup>/ditë**;
- frekuencën e realizimit të operacioneve të pastrimit gjatë sezonit turistik;
- segmentet e zonës së plazhit të përfshira në itineraret e pastrimit sipas organizimit të operacioneve të shërbimit.

llogaritja është bërë mbi njësi standarde (1000 m<sup>2</sup>) dhe më pas shkallëzohet sipas sipërfaqes reale

Volumi i operacioneve të pastrimit dhe organizimi i itinerareve të ekipeve të punës janë përcaktuar në modelin e dimensionimit të shërbimit në bazë të sipërfaqeve të plazhit dhe të frekuencës së realizimit të operacioneve të pastrimit.

### 6.3 Organizimi i shërbimit

Shërbimi i pastrimit të sipërfaqeve të plazhit realizohet nga ekipe të dedikuara pune të pajisura me mjete dhe pajisje manuale për realizimin e operacioneve të pastrimit.

Ekipet e punës operojnë në bazë të itinerareve të përcaktuara për realizimin e operacioneve të pastrimit në territorin e zonës së plazhit.

Numri i punonjësve të angazhuar në realizimin e këtij shërbimi përcaktohet në bazë të volumit të sipërfaqeve që duhet të pastrohen dhe të normave teknike të produktivitetit të përdorura për dimensionimin e shërbimit.

### 6.4 Metodologjia e realizimit të shërbimit

Procesi i realizimit të operacioneve të pastrimit të plazhit përfshin fazat e mëposhtme:

#### **Kontrolli i zonës së plazhit**

Ekipi i shërbimit realizon kontrollin e zonës së plazhit për evidentimin e mbetjeve të depozituara në sipërfaqen e rërës.

#### **Mbledhja e mbetjeve**

Realizohet mbledhja manuale e mbetjeve të depozituara në sipërfaqen e plazhit, duke përfshirë mbetje plastike, letre, mbetje organike dhe materiale të tjera të shpërndara në territor.

#### **Grumbullimi i mbetjeve**

Mbetjet e mbledhura grumbullohen në pika të përkohshme përgjatë itinerarit të pastrimit.

## **Transportimi i mbetjeve**

Mbetjet e grumbulluara transportohen drejt pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane ose depozitohen në kontejnerët përkatës të mbetjeve.

### **6.5 Parametrat teknikë**

Parametrat teknikë për realizimin e shërbimit të pastrimit të sipërfaqeve të plazhit përcaktohen në bazë të sipërfaqes së plazhit që duhet të pastrohet dhe të normave teknike të produktivitetit të ekipeve të punës.

Këta parametra përdoren për përcaktimin e numrit të punonjësve dhe të mjeteve të nevojshme për realizimin e operacioneve të pastrimit të zonave të plazhit.

### **6.6 Mjetet dhe pajisjet**

Për realizimin e shërbimit të pastrimit të sipërfaqeve të plazhit përdoren mjete dhe pajisje manuale të përshtatshme për realizimin e operacioneve të pastrimit në sipërfaqe me rërë.

Këto mjete përfshijnë:

- lopata dhe mjete për mbledhjen e mbetjeve;
- karroca transporti për mbetjet;
- qese ose kontejnerë për grumbullimin e mbetjeve.

### **6.7 Grafiku i punimeve**

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të sipërfaqeve të plazhit përgatiten nga operatori i shërbimit në bazë të itinerareve të punës dhe të frekuencave të realizimit të operacioneve të pastrimit gjatë sezonit turistik.

Grafikët e punimeve miratohen nga Autoriteti Kontraktor dhe përbëjnë bazën për organizimin dhe realizimin e operacioneve të pastrimit të zonave të plazhit.

## **7. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e kontejnerëve**

### **7.1 Përshkrimi i shërbimit**

Shërbimi i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së kontejnerëve konsiston në administrimin, vendosjen, identifikimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontejnerëve të përdorur për grumbullimin e mbetjeve urbane në territorin e zonës së shërbimit.

Operatori i shërbimit është përgjegjës për garantimin e funksionimit normal të kontejnerëve dhe për realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës. Kontejneret e demtuar apo që kanë nevojë për riparim, transportohen në park nga makina e cila kryen edhe zërin “Mirëmbajtje PGM”

### **7.2 Vendosja dhe identifikimi i kontejnerëve**

Vendosja e kontejnerëve në territorin e zonës së shërbimit përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor.

Gjatë zbatimit të kontratës operatori i shërbimit mund të realizojë zhvendosjen e kontejnerëve në bazë të kërkesave të paraqitura dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

Çdo kontejner duhet të identifikohet me një numër rendor ose kod identifikimi që mundëson monitorimin dhe administrimin e tij.

Operatori i shërbimit duhet të mbajë një inventar të përditësuar të kontejnerëve të vendosur në territorin e zonës së shërbimit.

### 7.3 Organizimi i shërbimit

Shërbimi realizohet nga ekipet e operatorit të shërbimit të cilat janë përgjegjëse për kontrollin periodik të gjendjes së kontejnerëve ku me kërkesë dhe miratim të Autoritetit Kontraktor realizon ndërhyrjet e nevojshme për mirëmbajtjen e tyre

Ekipet e shërbimit operojnë në bazë të itinerareve të përcaktuara për kontrollin dhe administrimin e kontejnerëve.

### 7.4 Metodologjia e realizimit të shërbimit

Realizimi i shërbimit përfshin operacionet e mëposhtme.

#### Kontrolli i gjendjes së kontejnerëve

Autoriteti Kontraktor realizon kontrollin periodik të kontejnerëve për evidentimin e dëmtimeve ose problematikave që mund të ndikojnë në funksionimin e tyre dhe udhëzon operatorin e shërbimit për ndërhyrjet e nevojshme.

#### Riparimi i kontejnerëve

Kontejnerët e dëmtuar duhet të riparohen nga operatori i shërbimit për të garantuar funksionimin normal të tyre.

Operacionet e riparimit mund të përfshijnë:

- ndërrimin e rrotave;
- ndërrimin e dorezave;
- riparimin ose zëvendësimin e kapakut;
- riparimin e deformimeve të trupit të kontejnerit.

#### Zëvendësimi i kontejnerëve

Në rastet kur kontejnerët janë të dëmtuar në mënyrë të tillë që nuk mund të riparohen, operatori duhet të realizojë një zëvendësim prej 50 kontejnerësh brenda çdo viti.

Operatori duhet të mbajë një rezervë minimale kontejnerësh për zëvendësimin e përkohshëm të kontejnerëve të dëmtuar.

#### Zhvendosja e kontejnerëve

Në rastet kur është e nevojshme për përmirësimin e organizimit të shërbimit, kontejnerët mund të zhvendosen me miratimin dhe me kërkesën e Autoritetit Kontraktor në pozicione të tjera të përshtatshme në territorin e zonës së shërbimit.

### 7.5 Parametrat teknikë

Shërbimi i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së kontejnerëve realizohet në bazë të numrit të kontejnerëve të vendosur në territorin e zonës së shërbimit dhe të organizimit të pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane.

Numri i punonjësve dhe i mjeteve të nevojshme për realizimin e këtij shërbimi përcaktohet në bazë të modelit të dimensionimit të shërbimit.

### 7.6 Mjetet dhe pajisjet

Për realizimin e këtij shërbimi përdoren mjete dhe pajisje për transportin dhe mirëmbajtjen e kontejnerëve, të cilat mund të përfshijnë:

- kamionë për transportin e kontejnerëve;
- kamionçina për realizimin e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes;

Mjetet e përdorura për realizimin e këtij shërbimi duhet të jenë në përputhje me standardet mjedisore të Bashkimit Europian, minimalisht **Euro 5 ose standarde më të larta**.

## 7.7 Grafiku i punimeve

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së kontejnerëve përgatiten nga operatori i shërbimit në bazë të organizimit të pikave të grumbullimit dhe të itinerareve të kontrollit të kontejnerëve.

Grafikët e punimeve miratohen nga Autoriteti Kontraktor dhe përbëjnë bazën për realizimin e operacioneve të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së kontejnerëve.

## 8. Larja dhe dezinfektimi i kontejnerëve

### 8.1 Përshkrimi i shërbimit

Shërbimi i larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve konsiston në realizimin e operacioneve të pastrimit dhe dezinfektimit të kontejnerëve të mbetjeve urbane me përdorimin e mjeteve të specializuara për larjen e tyre.

Qëllimi i këtij shërbimi është garantimi i kushteve të përshtatshme higjienike në pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe parandalimi i zhvillimit të aromave të pakëndshme dhe mikroorganizmave.

### 8.2 Volumi i shërbimit

Volumi i shërbimit të larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve përcaktohet në bazë të analizës së territorit dhe të modelit të dimensionimit të shërbimit të paraqitur në tabelat analitike të përgatitura në modelin e llogaritjes.

Ky volum përfshin:

- numrin total të kontejnerëve të vendosur në territorin e zonës së shërbimit: 357 kontejnerë;
  - frekuencën e realizimit të operacionit të larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve: 1 herë në muaj për çdo kontejner;
  - numrin mesatar të kontejnerëve që lahen gjatë një dite pune: rreth 21 kontejnerë në ditë;
- Volumi i operacioneve të larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve dhe organizimi i itinerareve të mjeteve të specializuara janë përcaktuar në modelin e dimensionimit të shërbimit në bazë të numrit të kontejnerëve, frekuencës së realizimit të operacioneve dhe kapacitetit operativ të mjeteve të larjes

### 8.3 Organizimi i shërbimit

Shërbimi i larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve realizohet nga një autobot i cili shkon në çdo pike grumbullimi mbetjesh dhe ben larjen e tyre me uje dhe solucion pastrues dhe desinfektues.

Ekipet e punës operojnë në bazë të itinerareve të përcaktuara për realizimin e operacioneve të larjes në territorin e zonës së shërbimit.

### 8.4 Metodologjia e realizimit të shërbimit

Shërbimi i larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve realizohet me autoboot. Ky shërbim behet gjithë kur kontejneri është i zbrazur nga mbetjet.

Procesi i realizimit të këtij shërbimi përfshin hapat e mëposhtëm:

- Afrimin e autobotit në pikën e grumbullimit të kontejnerëve sipas itinerarit të punës;
- vendosjen e kontejnerit në pozicion të favorshëm për kryerjen e procesit,
- realizimin e procesit të larjes së brendshme dhe të jashtme të kontejnerit me ujë me presion;
- aplikimin e solucionit desinfektues për eliminimin e baktereve dhe të aromave të pakëndshme;
- Rivendosjen e kontejnerit në pozicionin e tij fillestar.

Operacionet e larjes dhe dezinfektimit realizohen në mënyrë të tillë që të garantohet pastrimi efektiv i kontejnerëve dhe të shmangët ndotja e mjedisit gjatë procesit të larjes dhe solucion të jone miqesore me mjedisin.

### **8.5 Mjetet dhe pajisjet**

1(nje) autobot me kapacitet mbajtes uji jo me pak se 2000 litra i pajisur gjithashtu me pompë dhe pistoletë uji për larjen me presion dhe dezinfektimin e konteinerëve. Mjetet e përdorura për realizimin e këtij shërbimi duhet të jenë në përputhje me standardet mjedisore të Bashkimit European, **minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta.**

### **8.6 Grafiku i punimeve**

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve përgatiten nga operatori i shërbimit në bazë të itinerareve të punës dhe të frekuencave të realizimit të operacioneve të larjes.

Grafikët e punimeve miratohen nga Autoriteti Kontraktor dhe përbëjnë bazën për realizimin e operacioneve të larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve në territorin e zonës së shërbimit.

## **9. Mirëmbajtja dhe pastrimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve (PGM)**

### **9.1 Përshkrimi i shërbimit**

Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave të grumbullimit të mbetjeve konsiston në realizimin e operacioneve të pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave ku janë vendosur kontejnerët për mbledhjen e mbetjeve urbane.

Ky shërbim ka për qëllim ruajtjen e pastërtisë dhe të kushteve higjienike në zonat ku janë vendosur kontejnerët dhe parandalimin e përhapjes së mbetjeve në hapësirat publike përreth.

### **9.2 Volumi i shërbimit**

Volumi i shërbimit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave të grumbullimit të mbetjeve (PGM) përcaktohet në bazë të analizës së territorit dhe të modelit të dimensionimit të shërbimit të paraqitur në tabelat analitike të përgatitura në modelin e llogaritjes.

Ky volum përfshin:

- numrin e pikave të grumbullimit të mbetjeve të vendosura në territorin e zonës së shërbimit: 66 PGM, qe përfshijne pgm ne rruget kryesore dhe ato prane zones turistike.
- frekuencën e realizimit të operacioneve të pastrimit dhe mirëmbajtjes: çdo ditë per 93 dite;
- orarin e realizimit të shërbimit: nga ora 10:00 deri në orën 18:00;
- operacionet e pastrimit të sipërfaqeve përreth kontejnerëve dhe të hapësirave të përdorura për vendosjen e tyre;
- itineraret e ekipeve të punës për realizimin e operacioneve të mirëmbajtjes dhe pastrimit të PGM.

Volumi i operacioneve të mirëmbajtjes dhe pastrimit të PGM dhe organizimi i itinerareve të ekipeve të punës janë përcaktuar në modelin e dimensionimit të shërbimit në bazë të numrit të pikave të grumbullimit, frekuencës së realizimit të operacioneve dhe organizimit të përgjithshëm të shërbimit të pastrimit urban

### **9.3 Organizimi i shërbimit**

Shërbimi realizohet nga ekipet e operatorit të shërbimit të cilat janë përgjegjëse për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave ku janë vendosur kontejnerët e mbetjeve urbane. Ekipet operojnë në bazë të itinerareve të punës të përcaktuara për realizimin e operacioneve të pastrimit në territorin e zonës së shërbimit.

#### 9.4 Metodologjia e realizimit të shërbimit

Realizimi i operacionit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave të grumbullimit përfshin fazat e mëposhtme.

##### Kontrolli i gjendjes së pikës së grumbullimit

Operatori realizon kontrollin e gjendjes së pikës së grumbullimit për të evidentuar praninë e mbetjeve të shpërndara ose të depozituara jashtë kontejnerëve.

##### Mbledhja e mbetjeve të shpërndara

Mbetjet e shpërndara përreth kontejnerëve mbledhen dhe vendosen në kontejnerët përkatës ose në mjetet e grumbullimit të mbetjeve.

##### Pastrimi i sipërfaqes përreth kontejnerëve

Realizohet pastrimi i sipërfaqes përreth kontejnerëve për largimin e papastërtive dhe mbetjeve të vogla.

##### Largimi i mbetjeve voluminoze

Në rastet kur në pikat e grumbullimit janë depozituar mbetje voluminoze ose mbetje të tjera jashtë kontejnerëve, realizohet largimi i tyre nga ekipi i shërbimit dhe transportimi drejt vendeve të përcaktuara për depozitim të tyre.

#### 9.5 Parametrat teknikë

Parametrat teknikë për realizimin e këtij shërbimi përcaktohen në bazë të numrit të pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe të frekuencës së realizimit të operacioneve të pastrimit.

Numri i punonjësve dhe i mjeteve të nevojshme për realizimin e këtij shërbimi përcaktohet në bazë të modelit të dimensionimit të shërbimit.

#### 9.6 Mjetet dhe pajisjet

Për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave të grumbullimit të mbetjeve (PGM) përdoren mjete dhe pajisje ndihmëse të përshtatshme për realizimin e operacioneve të pastrimit të sipërfaqeve përreth kontejnerëve.

Ekipet e punës duhet të jenë të pajisura me:

- mjete manuale për pastrimin e sipërfaqeve përreth kontejnerëve;
- pajisje për mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve të shpërndara në zonën e pikave të grumbullimit;
- pajisje për transportin dhe largimin e mbetjeve të mbledhura gjatë operacioneve të pastrimit;

Për realizimin e këtij shërbimi përdoren gjithashtu **1 mjet transporti tip kamionçinë me kapacitet rreth 3.5 ton**, të cilat shërbejnë për transportin e pajisjeve të punës dhe për largimin e mbetjeve të mbledhura gjatë operacioneve të mirëmbajtjes së pikave të grumbullimit.

#### 9.7 Grafiku i punimeve

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave të grumbullimit të mbetjeve përgatiten nga operatori i shërbimit në bazë të itinerareve të punës dhe të frekuencave të realizimit të operacioneve të pastrimit.

Grafikët e punimeve miratohen nga Autoriteti Kontraktor dhe përbëjnë bazën për realizimin e operacioneve të mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave të grumbullimit të mbetjeve në territorin e zonës së shërbimit.

## 10. Mirëmbajtja e rrugëve kryesore

### 10.1 Përshkrimi i shërbimit

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve kryesore përfshin realizimin e operacioneve të pastrimit dhe të mirëmbajtjes së segmenteve kryesore të rrjetit rrugor të zonës së shërbimit.

Ky shërbim synon ruajtjen e kushteve të përshtatshme të pastërtisë dhe funksionalitetit të rrugëve kryesore dhe përfshin mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të depozituara në sipërfaqen e rrugës, pastrimin e materialeve të shpërndara dhe ndërhyrjet e nevojshme për mirëmbajtjen e sipërfaqes rrugore.

### 10.2 Volumi i shërbimit

Volumi i shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve kryesore përcaktohet në bazë të analizës së territorit dhe të modelit të dimensionimit të shërbimit të paraqitur në tabelat analitike të përgatitura në modelin e llogaritjes.

Ky volum përfshin:

- Siperfaqen e rrugëve kryesore që përfshihen në operacionin e mirëmbajtjes: 15400 m<sup>2</sup>;
- frekuencën e realizimit të operacionit të mirëmbajtjes së rrugëve kryesore: 93 dite pergjate sezonit turistik.
- orarin e realizimit të shërbimit: nga ora 10:00 deri në orën 18:00;
- segmentet rrugore kryesore të përfshira në itineraret e mirëmbajtjes sipas organizimit të operacioneve të pastrimit.

Volumi i operacioneve të mirëmbajtjes së rrugëve kryesore dhe organizimi i itinerareve të ekipeve të punës janë përcaktuar në modelin e dimensionimit të shërbimit në bazë të gjatësisë së segmenteve rrugore, frekuencës së realizimit të operacioneve dhe organizimit operacional të shërbimit.

### 10.3 Organizimi i shërbimit

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve kryesore realizohet nga ekipe të dedikuara pune të pajisura me mjete dhe pajisje të përshtatshme për realizimin e operacioneve të pastrimit dhe mirëmbajtjes së segmenteve rrugore.

Në bazë të modelit të dimensionimit të shërbimit dhe të volumit të operacioneve të mirëmbajtjes, realizimi i këtij shërbimi parashikon angazhimin e **3 punonjësve**, të cilët operojnë sipas itinerareve të përcaktuara për realizimin e operacioneve të mirëmbajtjes në segmentet rrugore kryesore të zonës së shërbimit.

Punonjësit realizojnë operacionet e mirëmbajtjes gjatë orarit të operimit **nga ora 10:00 deri në orën 18:00**.

### 10.4 Metodologjia e realizimit të shërbimit

Procesi i realizimit të këtij shërbimi përfshin:

- identifikimin e segmenteve rrugore që kërkojnë ndërhyrje për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqes rrugore;
- mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve të depozituara në sipërfaqen e rrugës;
- pastrimin e materialeve të shpërndara në sipërfaqen e rrugës;
- transportin dhe largimin e mbetjeve të mbledhura gjatë operacioneve të mirëmbajtjes.

### 10.5 Parametrat teknikë

Parametrat teknikë për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve kryesore përcaktohen në bazë të volumit të operacioneve të mirëmbajtjes dhe të organizimit operacional të ekipeve të punës.

### 10.6 Mjetet dhe pajisjet

Për realizimin e këtij shërbimi përdoren mjete dhe pajisje ndihmëse për pastrimin e sipërfaqeve rrugore dhe për mbledhjen e mbetjeve të depozituara në rrugë.

Ekipet e punës janë të pajisura me mjete manuale për pastrimin e sipërfaqeve rrugore dhe me mjete transporti për largimin e mbetjeve të mbledhura gjatë operacioneve të mirëmbajtjes.

### **10.7 Grafiku i punimeve**

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve kryesore përgatiten në bazë të itinerareve të punës dhe të frekuencës së realizimit të operacioneve të mirëmbajtjes në segmentet rrugore kryesore të zonës së shërbimit.

### **11. Mirëmbajtja e WC Publike**

Plazhi i Velipojës ka katër WC publike që kërkojnë të mirëmbahen gjatë sezonit turistik prej 93 ditësh. Për këtë janë planifikuar 5 punëtorë për të katër tualetet publike, nga një punëtor për çdo tualet për shtatë ditët e javës dhe dy punëtorë rezervë të cilët do të angazhohen në rast nevojë të Autoritetit Kontraktor (AK) nga operatori sipërmarrës.

Në analizën e kostos janë përllogaritur edhe ditët e festave dhe fundjavës. Në zbatim të kuadrit ligjor përkatës.

Stafi duhet të jetë i pajisur me rroba të përshtatshme për punën, me logo të Bashkisë dhe të operatorit. Tualetet, gjatë përdorimit, duhet të kenë gjithashtu pajisjet e nevojshme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, të gjitha të planifikuara në analizën e kostos.

Listat e punonjësve duhet t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor me kërkesën e tij. Autoriteti Kontraktor realizon monitorimin e realizimit të shërbimit nga ana e operatorit dhe, nëse vihen re mosrealizime të kritereve dhe kushteve të kontratës, ndërmerren penalizimet e përcaktuara në kontratë.

### **12. Modeli i dimensionimit të shërbimit**

#### **12.1 Parimet e dimensionimit të shërbimit**

Dimensionimi i shërbimit të pastrimit urban është realizuar në bazë të analizës së territorit të zonës së shërbimit dhe të volumit të operacioneve të pastrimit që duhet të realizohen.

Modeli i dimensionimit të shërbimit bazohet në përcaktimin e volumit të punimeve për çdo zë shërbimi dhe në përdorimin e normave teknike të produktivitetit për llogaritjen e burimeve të nevojshme për realizimin e shërbimit.

Ky model mundëson përcaktimin e:

- numrit të punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimit;
- numrit dhe kapacitetit të mjeteve të shërbimit;
- organizimit operativ të ekipeve të punës.

#### **12.2 Volumet e shërbimit**

Volumet e shërbimit janë përcaktuar në bazë të analizës së territorit dhe të sipërfaqeve që përfshihen në operacionet e pastrimit.

Për çdo zë shërbimi janë përcaktuar:

- sipërfaqet që duhet të pastrohen;
- numri i pikave të grumbullimit të mbetjeve;
- numri i kontejnerëve të vendosur në territor;
- frekuenca e realizimit të operacioneve të pastrimit.

Këto volumet janë përfshirë në modelin analitik të përgatitur në tabelat e llogaritjes së shërbimit.

### 12.3 Normat teknike të produktivitetit

Për dimensionimin e shërbimit janë përdorur norma teknike të produktivitetit për çdo operacion të pastrimit.

Këto norma përcaktojnë kapacitetin mesatar të punës për:

- një punonjës gjatë një dite pune;
- një mjet gjatë një turni operimi.

Normat teknike përdoren për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve të nevojshme për realizimin e volumit të punimeve.

### 12.4 Llogaritja e burimeve të shërbimit

Në bazë të volumit të punimeve dhe të normave teknike të produktivitetit realizohet llogaritja e burimeve të nevojshme për realizimin e shërbimit.

Procesi i llogaritjes përfshin:

- përcaktimin e volumit ditor të punimeve;
- përcaktimin e produktivitetit të punonjësve dhe mjeteve;
- llogaritjen e numrit të punonjësve dhe të mjeteve të nevojshme për realizimin e shërbimit.

### 12.5 Punonjësit rezervë

Për realizimin e shërbimeve që kryhen në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit është parashikuar një numër punonjësish rezervë për zëvendësimin e punonjësve gjatë periudhave të pushimeve, mungesave ose situatave të tjera që mund të ndikojnë në realizimin e shërbimit.

Për shërbimet që realizohen gjatë gjithë vitit pa ndërprerje përdoret koeficienti i zëvendësimit:

$$365 / 272$$

Ky koeficient përdoret për përcaktimin e numrit total të punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimit gjatë gjithë vitit.

Për shërbimet që nuk realizohen me angazhim të plotë ditor nuk parashikohen punonjës rezervë.

### 12.6 Organizimi i shërbimit

Në bazë të dimensionimit të shërbimit përcaktohet organizimi operativ i shërbimit, i cili përfshin:

- ekipet e punës për realizimin e operacioneve të pastrimit;
- mjetet e përdorura për realizimin e operacioneve të pastrimit;
- itineraret dhe grafikët e punimeve.

### 12.7 Modeli i llogaritjes së kostos

Modeli i dimensionimit të shërbimit është përfshirë në tabelat analitike të përgatitura në modelin e llogaritjes së shërbimit.

Në këto tabela janë përfshirë:

- volumet e punimeve për çdo zë shërbimi;
- normat teknike të përdorura për dimensionimin e shërbimit;
- numri i punonjësve dhe i mjeteve të nevojshme për realizimin e operacioneve të pastrimit.

Këto tabela përbëjnë bazën për përcaktimin e organizimit teknik dhe ekonomik të shërbimit.

### **13. Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë së shërbimit**

#### **13.1 Parimet e monitorimit të shërbimit**

Realizimi i shërbimit të pastrimit monitorohet nga Autoriteti Kontraktor me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave teknike të përcaktuara në këtë dokument dhe të realizimit të operacioneve të pastrimit sipas itinerareve dhe grafikëve të punimeve.

Monitorimi i shërbimit synon garantimin e një niveli të përshtatshëm pastërtie në territorin e zonës së shërbimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së operacioneve të pastrimit.

#### **13.2 Kontrolli i realizimit të shërbimit**

Kontrolli i realizimit të shërbimit përfshin verifikimin e:

- realizimit të operacioneve të pastrimit sipas frekuencave të përcaktuara;
- respektimit të itinerareve të punës;
- angazhimit të mjeteve dhe të personelit të nevojshëm për realizimin e shërbimit;
- nivelit të pastërtisë në rrugë, trotuare dhe hapësira publike.

Kontrollet mund të realizohen në mënyrë periodike ose të rastësishme nga Autoriteti Kontraktor gjatë realizimit të shërbimit.

#### **13.3 Raportimi i operatorit të shërbimit**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë raportimin periodik të realizimit të operacioneve të pastrimit.

Raportimi mund të përfshijë informacion mbi:

- realizimin e itinerareve të punës;
- operacionet e realizuara gjatë periudhës së raportimit;
- mjetet dhe ekipet e angazhuara në realizimin e shërbimit;
- problematikat e evidentuara gjatë realizimit të operacioneve të pastrimit.

Raportet e realizimit të shërbimit i paraqiten Autoritetit Kontraktor sipas formës dhe periodicitetit të përcaktuar në kontratë.

#### **13.4 Evidentimi i problematikave**

Gjatë realizimit të shërbimit mund të evidentohen problematika që lidhen me organizimin e operacioneve të pastrimit ose me gjendjen e territorit.

Operatori i shërbimit duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për problematikat e evidentuara dhe të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e tyre.

#### **13.5 Masa për përmirësimin e shërbimit**

Në rastet kur gjatë monitorimit evidentohet se shërbimi nuk realizohet në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në këtë dokument, operatori i shërbimit është i detyruar të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e realizimit të operacioneve të pastrimit.

Masat për përmirësimin e shërbimit mund të përfshijnë:

- riorganizimin e itinerareve të punës;
- rritjen e angazhimit të mjeteve ose të ekipeve të punës;
- ndërhyrje shtesë për realizimin e operacioneve të pastrimit.

Mjetet dhe stafi I duhur per realizimin shërbimeve te pastrimit Zona Perendimore


Zeri I punimeve	dite pune/ vit	Frekuenca e sherbimeve	Numri shofereve permanent	Numri punetoreve permanent	Numri shofereve sezonale	Numri punetoreve sezonale	Mjetet	Cope	rezerve
Grumbullim dhe transport I mbejeteve Ana e Malit-Berdice-Dajç-Velipoje rural	312.124	Permanent	2	4			Kompatator 10 ton	1	1
Grumbullim dhe transport I mbejeteve Velipoje gjate dites	93	Sezonale			1	2	Kompatator 7 ton	1	
Grumbullim dhe transport I mbejeteve Velipoje gjate nates(zona prane plazhit)	365	Permanent	1	2			Kompatator 7 ton		
Grumbullim dhe transport I mbejeteve Velipoje sezon turistik	93	Sezonale			1	2	Kompatator 10 ton	1	
Menaxhim dhe mirembajtje e konteniereve	1	Permanent		1		0			
Fshirje manuale rruge , trotuare dhe sheshe	93	Sezonale		0		1			
Pastrimi I sip te plazheve	93	Sezonale				6			
Larje konteineresh	216	Permanent	1	1			Autobot I pajisur me pompe me presion	1	
Mirembajtja e rrugeve kryesore	93	Sezonale				3			
Mirembajtja e PGM Velipoje	93	Sezonale	1	2			Makine transporti kapacitet deri 3.5 ton	1	
Mirembajtja e 4 tualeteve publike ne zonen e plazhit Velipoje (8 punetore)	93	Sezonale				10			
<b>Total</b>			<b>5</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>24</b>		<b>5</b>	<b>1</b>

Të gjitha mjetet duhet të përmbushin standardet mjedisore të Bashkimit Europian, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta.









### Ndalesat për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale

Kontraktuesi do t'i nënshtrohet ndalesave nga Autoriteti Kontraktor, Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike Shkodër, si më poshtë vijon:

- 1- Për mospërbushje të detyrimit për **“Mbledhje grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane”**, kur konstatohen rastet:
  - a. **Kontenier i pa evaduar:** Në rastin e konstatimit të punës të pa kryer sipas specifikimeve teknike dhe grafikut, kontraktuesi penalizohet me 5000 (pesë mijë) lekë për çdo kontenier të pa evaduar ditor.
  - b. **Pikë Grumbullimi Mbeturinas e pa pastruar, mbetje në tokë, në një rreze deri në 5m nga të gjitha anët e pikës së grumbullimit:** Kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo pikë grumbullimi mbetjesh të papastruar ditor.
  - c. **Gjatë transportit të mbetjeve urbane, konstatohet që mjeti teknologjik ka rrjedhje vajrash apo lëngjesh nga kazani i makinerisë:** Kontraktuesi penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për raste të konstatuara.
- 2- Për mospërbushje të detyrimit për **“Dezifektim të pikës grumbullimit mbetjeve”**, kur konstatohet se:
  - a. **Pikë Grumbullimi Mbetjesh e padizefektuar sipas grafikut:** Kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për pikë grumbullimi mbetjesh.
- 3- Për mospërbushje të detyrimit për **“Menaxhim dhe mirëmbajtje kontenierësh”** kur konstatohen rastet:
  - a. **Kontenier i pa larë:** Kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo kontenier të pa larë.
  - b. **Kontenier i dëmtuar:** Per çdo kontenier të dëmtuar, (rrota të hequra, deformime mekanike, lyerje me boje, etj.) i cili nuk rregullohet brenda 5-ditëve të lajmërimit nga

- Autoriteti Kontraktor, kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo kontenier të pa riparuar.
- 4- Për mospërmbushje të detyrimit për **“Fshirje manuale e rrugëve, pedonale dhe trotuareve”**, kur konstatohen rastet:
    - a. **Rrugë, pedonale dhe trotuar të pafshirë manualisht:** kontraktuesi do të penalizohet për sipërfaqen e pafshire me 5 (pesë) fish-in e çmimit të zërit përkatës të preventivit.
    - b. **Gjatë procesit të fshirjes manuale të rrugëve, pedonale dhe trotuareve, konstatohet se punonjësit e shërbimit të pastrimit, hedhin mbetje në vende të palejuara, në sistemin e kanalizimeve apo të burimeve ujore:** Kontraktuesi penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo rast të konstatuar dhe duhet të pastroje vendin me kosto të tij.
  - 5- Për mospërmbushje të detyrimit për **“Depozitim i mbetjeve urbane në Landfill”**, kur konstatohet:
    - a. **Mosdepozitim i mbetjeve urbane në landfill:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo rast të konstatuar për hedhjen e mbeturinave në vend të pa autorizuar.
  - 6- Për mospërmbushje të detyrimit për **“Pajisjen e punonjësve me uniforma sigurie dhe me mjetet e sigurimit teknik”**, kur konstatohet se:
    - a. **Punonjësit nuk janë pajisur me uniforma dhe me mjetet e sigurimit teknik, sipas specifikimeve teknike:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo punonjës të konstatuar. Masa e penaltetit do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.
  - 7- Për mospërmbushje të detyrimit **“të të pasurit në punë çdo ditë të numrit të mjeteve teknologjike”**, kur konstatohet se:
    - a. **Nuk punojnë çdo ditë të gjitha mjetet teknologjike sipas specifikimeve teknike dhe grafikeve të punëve,** gje që sjell mosrespektim të frekuencave dhe të orareve të kryerjes së shërbimeve, Kontraktuesi do të penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo mjet të munguar.
  - 8- Për mospermbushje të detyrimit **“të prezencës në punë të numrit të punonjësve” kur konstatohet se** nuk është prezenca e plotë e punonjësve sipas specifikimeve dhe grafikeve ditore, Kontraktuesi do të penalizohet në masen 5000 (pesë mijë ) lekë për çdo punonjës të munguar.
  - 9- **Nëse nuk realizohet mirmbajtja e PGM've përcaktuar për sezonin turistik** dhe konstatohet kjo punë e pa kryer nga operatori: Kontraktuesi do të penalizohet në masën 5000 ( pesë mijë ) lekë për cdo PGM'të pa mirembajtur.
  - 10- **Nëse konstatohet WC publike e pa mirmbajtur e ndotur dhe pa punëtor të pranishëm në vendin e punës** sipas specifikimeve teknike: Kontraktuesi penalizohet me 10 000 ( dhjetë mijë ) lekë për cdo WC Publike të pa mirembajtur.
  - 11- **Kur konstatohet se kontraktuesi ka fikur sistemin e GPS të mjeteve teknologjike, gjatë procesit të grumbullimit dhe transportit për në lendfill të mbetjeve urbane dhe jo urbane si dhe mjetet e tjera teknologjike sipas specifikimeve teknike:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 100 000 njëqind mijë lekë për cdo rast të konstatuar. Kontraktuesi do të gjobitet me të njëjtën vlerë në rastin kur ai nuk ofron të

dhënat e kërkuara për raportim, supervizim dhe llogaritje. Masa e penaltetit do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.

**12- Kur konstatohet që mjetet operojnë jashtë zonës së shërbimit, kontraktuesi do të penalizohet në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë për çdo mjet të konstatuar.**

**13- Penaltitetet dhe gjobat e aplikuara sipas kësaj Kontratë, nuk përjashtojnë masat e tjera penalizuese, që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.**

**14- Çdo tentativë ose praktikë për të influencuar rezultatin e monitorimit të cilësisë së shërbimit dhe sasive me kercënim apo avantazhe ndaj grupit të monitorimit, familjes apo miqve do të penalizohet me 20 % ulje të preventivit mujor kur vendimi merret nga Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike. Këto praktika korruptive do t'i japin Autoritetit Kontraktor të drejtën për të ndalur Kontratën për një periudhë prej 6 muajsh dhe të iniciojë procedim penal.**